



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:282216
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05747452

C- III- 15- 0643

Paditës: G M Gj nga fshati G, të cilin e përfaqëson avokati G K nga Istogu, e këtë avokatja A G nga Prishtina.

Kundër

Të paditurës: NSH KB „Gurrakoc”, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rr. „Driton Hoxha” 55, përfaqësuar me autorizim nga N K.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar, i përberë nga Gjyqtari Kryesues Hasim Sogojeva dhe Gjyqtarët anëtar Ganimete Puka dhe Hajrie Shala, pas mbajtës së seancës dëgjimore publike, më dt. 18 prill 2024, më dt. 21 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit G M Gj me të cilën ka kërkuar të vërtetohet se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë nga baza e mbajtjes në palujatshmerin, si pjesë e ngastrës kadastrale me nr. ..., që ka sipërfaqe 25286m², dhe atë sipërfaqen prej 0.87.63ha, dhe pjesën e ngastrës nr. ..., me sipërfaqe prej 2050m², me kulturë tokë bujqësore, arë, klasa 5, të dyja ngastrat, në vendin e quajtur „...” ZK T, Komuna e Istogut.

II. Secila palë i heq shpenzimet e veta të procedurës .

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Më dt. 21.09.2015, pranë DHPGJS është ushtruar padia e paditësit kundër të paditurit me të cilën është deklaruar se paditësi e ka blerë ngastrën me nr. ..., ZK T nga shitësi D M në vitin 1960, pronë kjo edhe sot e kësaj dite është në emër të shitësit, por ngastra është në kuadër të pjesës së ngastrës nr. ... Ngastra nr. ..., është në emër të paditurës nga e cila pronë babai i paditësit po ashtu nga shitësi në atë kohë e ka blerë sipërfaqen 0.87.67ha, të cilën e shfrytëzon dhe e posedon, të njëjtin fat e ka edhe ngastra nr. ..., pjesën e saj në sipërfaqe 0.19.95ha.

Ngastrat të cilat janë cekur më larë, paditësi i mban në posedim dhe shfrytëzim nga viti 1960, ka ndërtuar shtëpi, e ka rregulluar oborrin, dhe objektet përcjellëse, ekziston edhe mexha, dhe bimë shumë vjeçare, nga të cilat mund të kuptohet në shikimin e parë. Paditësi asnjëherë nuk ka pasur asnjë kërkesë nga askush rreth kësaj prone dhe të gjithë fqinjët e kanë të ditur këtë fakt. Deri sa ka funksionuar si organizatë bujqësore- Kooperativa - paditura nuk ia ka mohuar paditësit të drejtën e pronësisë. Me qenë se paditësi të drejtën e pronësisë në ngastrat kontestuese e ka fituar të drejtën e pronësisë nga baza e mbajtjes për më tepër se 50 vite, në pajtim me dispozitën e nenit 20 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, konsiderojmë se e paditura duhet t'ia mundëson me regjistru këtë të drejtë në regjistrat publikë.

Ka bashkangjitur me padi provat:

- Certifikatën për njësi kadastrale P-..., ZK T
- Certifikatën për njësi kadastrale P-..., ZK T,
- Skica e terrenit, dt 04.08.2015 e punuar nga B G dhe S P për ngastrat kontestuese,
- Aro incizimi për ngastra,
- Padia e ushtruar në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega Istog, C.nr.215/15.

Me dt. 08.04.2022, DHPGJS-ja ka lëshuar urdhrin C-III-15-0643 për paditësin me të cilën i ka kërkuar paditësit të plotëson padinë e tij ashtu që të deklarohet në lidhje me legjitimitetin aktiv, pastaj për blerjen e pronës a' posedon kontratë me shkrim, prona a' ka objekte të ndërtuara, kur janë ndërtuar, të dorëzon historiatin e pronës, raportin me shkrim të ekspertit të gjeodezisë duke identifikuar dhe incizuar pronat me matje gjeodezike dhe kufijtë e saj, dhe pas hartimit të ekspertizës, kërkesëpadia të precizohet për ngastrat lëndore duke u bazuar në ekspertizë.

Me dt. 26.04.2022, avokati G K ka dorëzuar parashtresën, me të cilën e ka njoftuar Gjykatën se nuk ka mundësi të veprojnë sipas urdhrit, duke kërkuar një afat më të gjatë.

Me dt. 16.05.2022, DHPGJS-ja e ka njoftuar paditësin se i vazhdohet afati për plotësimin e padisë edhe për 30 ditë, nga dita e pranimit të njoftimit.

Me dt. 17.06.2022 avokati G K ka dorëzuar parashtresën për rregullimin dhe precizimin e kërkesë padisë. Me këtë parashtresë avokati nuk është deklaruar fare në lidhje me çështjen e legjitimitetit aktiv të palës në procedurë, dhe në lidhje me raportin juridiko -civil të paditësit, me të paditurën. Pastaj nuk është deklaruar fare në lidhje me pjesën e ndryshimit të kërkesëpadiës, pasi me këtë parashtresë ka kërkuar pronësinë në pjesën e ngastrës nr. ..., derisa në padi bazë ka kërkuar ngastrën nr. ..., kurse me certifikatë të pronës është shënuar ngastra nr. ..., me sipërfaqe 29378m². Për këtë nuk ka dhënë asnjë sqarim faktik apo juridik lidhur me ngastrën, pjesën e ngastrës nr. 202- 1 për të cilën kërkon të drejtën e pronësisë.

Në parashtresë është deklaruar se nuk ka mundësi me siguruar historiatin e pronës për mungesë të dokumentacionit, ndërsa do të mundohemi që këtë provë ta sigurojmë në seancë dëgjimore.

Ka precizuar kërkesëpadinë siç ka theksuar duke u mbështetur në ekspertizë gjeodezike dt. 11.06.2022, dhe ka kërkuar :

“ Miratohet kërkesë padia e paditësit G Gj si e bazuar, vërtetohet se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë nga baza e mbajtjes në pjesën e ngastrës nr. ..., që ka sipërfaqe prej 25286 m² dhe atë sipërfaqe prej 0.87.63 ha dhe pjesën e ngastrës nr. ... që ka sipërfaqe prej 6582 m² në sipërfaqe prej 2050 m², me kulturë tokë bujqësore, arë klasa e 5, në vendin e quajtur “..” ZK T– Komuna

e Istogut pronë e të paditurës Kooperativa Bujqësore Gurakoc, Istog dhe detyrohet e paditura që paditësit t'ia pranojë të drejtën e pronësisë dhe të lejoj ta regjistrojë këtë pronë në emër të tij” .

Ka dorëzuar:

- Njoftimin për ushtrimin e padisë në AKP dt 15.06.2022,
- Raportin e ekspertit gjeodezik Gj M dt 14.06.2022 të cilit raport i është bashkangjitur skica e matjes së gjendjes faktike për ngastrat .. dhe .., incizimi orto foto, certifikatat për njësinë e pronës të cilat i ka dorëzuar edhe më herët , disa fotografi për dukje faktike të pronës.

Me dt. 11.07.2022 DHPGJS-ja ka lëshuar urdhrin për paditësin me të cilin i ka kërkuar që eksperti i gjeodezisë ta plotëson ekspertizën e tij si në raportin me shkrim, ashtu edhe me skicë të matjeve , ashtu që të përfshin të dhënat në lidhje me matjet gjeodezike, përkufizimet sipas gjendjes faktike në të gjitha drejtimet, dhe pas plotësimit paditësi të riprecizon kërkesëpadinë e cila duhet të jetë e kuptueshme dhe e përmbarueshme.

Me dt. 02.08.2022 , paditësi ka dorëzuar parashtresën përmes avokatit G K dhe së bashku me parashtresë ka dorëzuar raportin plotësues të ekspertit të gjeodezisë dhe skicën e matjes.

Me këtë parashtresë është deklaruar se po e bënë precizimin e kërkesëpadisë , mirëpo nga precizimi i kërkesëpadisë përsëri avokati G K nuk vepron sipas urdhrin të Gjykatës sepse i njëjti me precizim nuk ka bërë përshkrimin e matjeve dhe kufizimeve gjeodezike të pjesëve të ngastrave të kërkuara , që do të identifikonte këto pjesë të ngastrave nga pjesët tjera të cilën nuk e kërkon si pronësi. Avokati prapë nuk është deklaruar se pse tani në vend të ngastrës nr. ... , po kërkon ngastrën nr. ...

Ka bashkangjitur:

- Raportin me shkrim të ekspertit dt. 27.07.2022 në të cilin raport kësaj radhe janë përshkruar matjet dhe kufizimet gjeodezike të pjesës së ngastrës .. dhe të pjesës së ngastrës ..
- Skicën e matjeve me të cilën është bërë identifikimi i pjesëve të ngastrave për të cilat paditësi ka kërkuar pronësinë.

Me dt. 17.03.2023 DHPGJS-ja ka lëshuar urdhrin C-III.-15-0643 për të paditurin AKP , duke kërkuar të jep përgjigje ne padinë e paditësit dhe se të paditurës AKP iu janë dorëzuar parashtresat dhe provat që i kanë bashkangjitur paditësi, pra ekspertiza gjeodezike .

Me dt. 04.04.2023 AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtresën e përgjegjës në padi me të cilën ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, sikundër edhe provat të cilat i ka propozuar paditësi.

Në parashtresë është deklaruar se paditësi me provat e dorëzuara nuk ka argumentuar faktet e rëndësishme , siç janë : legjitimiteti aktiv i paditësit dhe legjitimiteti pasiv i të paditurës. Nuk ka argumentuar bazën ligjore me të cilën pretendon në të drejtën e pronësisë . Nga përmbajtja e padisë dhe provat e prezantuara ka theksuar nuk mund të vërtetohet se paditësi me të paditurën kanë pasur ndonjë raport pronësor juridik, nga e cila konsiderohet se e paditura në mënyrë të kundërligjshme e ka dëmtuar apo e ka privuar nga e drejta e pronësisë së paditësit. Në shkresat e lëndës nuk ekziston historiat apo prova që do të vërtetojnë se këto ngastra kanë qenë në pronësi të paraardhësit të paditësit, të evidentuar në emër të tij. Nga përmbajtja në padi paditësi thekson se pronën kontestuese e ka blerë nga një qytetar i kombësisë serbe , e cila pronë tani është e

regjistruar si pronësi shoqërore dhe shtrohet pyetja, se paditësi pse kërkesën e tij nuk e ka drejtuar ka shitësi që pretendon se e ka blerë.

Në disa raste kur e lejojnë mundësit ligjore dhe e autorizojnë AKP-në, AKP-ja ka një njësi të veçantë që drejtë për drejtë ti zgjidh kontestet me personat që pretendojnë në pronësi, por në rastin konkret, paditësi nuk ka ushtruar ndonjë kërkesë për negociim. Ka kundërshtuar ekspertizën e ekspertit gjeodezike se mungon historiat i pronës, ndërsa raporti i ekspertit është hartuar pa e bërë e mundshme të paditurës, me qenë prezent.

Ka kërkuar të refuzohet kërkesë padia.

Ka bashkangjitur si dëshmi kur AKP ka marr vendim për anulimin e shitjes.

Me dt. 14.02.2024 DHPGJS-ja, ka lëshuar njoftimin me të cilën palët janë njoftuar se Gjykata ka vendosur të caktoj seancë dëgjimore publike, për dt. 18.04.2024, në ora 09:30h.

Palët janë ftuar që për racionalizim të procedurës dhe kohës që me parashtresa me shkrim të deklarohen për pikëpamje shtesë në lidhje me çështjen juridike të kontestit pronësor.

Palët janë njoftuar për pasojën juridike në rast mungese në seancë dëgjimore dhe janë njoftuar se Gjykata nuk do të caktoj seancë tjetër dëgjimore, prandaj palëve iu është kërkuar të jenë të përgatitura për çështjet kontestuese, duke i siguruar të gjitha provat.

Gjykatës, asnjëra palë para mbajtjes së seancës dëgjimore, nuk i kanë dorëzuar parashtresat me shkrim për të dhënë shpjegime shtesë në lidhje me çështjen juridike, ose për të parashtruar ndonjë kërkesë.

Me dt. 18.04.2024 është mbajtur seanca dëgjimore publike në të cilën për paditësin ka prezantuar avokatja A G nga Prishtina, që e ka zëvendësuar avokatin G K, dhe për të paditurin ka prezantuar N K, me autorizim.

Për paditësin, avokatja A G është deklaruar: Mbetemi në tërësi pranë padisë, parashtresave për rregullim dhe precizim të kërkesë padisë, paditësi është pronar faktik i ngastrave nga viti 1960. Është deklaruar se ka kërkuar të nxirret si provë historiat i pronës për ngastrat .., .. për kundër përpjekjeve nuk kemi mundur ta sigurojmë historiatin për shkak të ngarkesës së madhe të arkivës, në Komunën e Istogut, ka kërkuar nga Gjykata që historiat i pronës të sigurohet zyrtarisht. Ka kërkuar nga Gjykata të dëgjohet paditësi në cilësinë e palës dhe se i njëjti jeton në shtetin e Suedisë ai do të vie gjatë muajit korrik apo gusht dhe kërkon se gjatë kësaj periudhe të caktohet një seancë dëgjimore, që ti jepet mundësia të deklarohet.

Përfaqësuesi i AKP-së është deklaruar: e kontestoj në tërësi kërkesë padinë si të pa bazuar dhe referati i padisë ashtu siç është shkruar është me plotë pa saktësi si kundër i kundërshtojmë propozimet e paditësit në seancën e sotme.

Si mund të thuhet se paditësi në vitin 1960 e ka blerë ngastrën me nr. .. në tërësi nga D M e cila ngastër është në emër të shitësit, atëherë pse paditësi ka nevojë të kërkoj tokën nga ndërmarrja shoqërore. Pastaj paditësi përpiqet ta ndërlidhë ngastrën nr. .. në lidhje me ngastrën me nr... për çka është e pa besueshme se në ngastër nuk mund të jetë edhe në pronësi të personit fizik dhe në pronësi të NSH-së. Më tej ka theksuar nëse ka ndodh shitblerja në vitin 1960 kush paska qenë dashur të jetë palë e paditur, shitësi apo NSH-ja me të cilin nuk ka raport juridiko pronësor.

Ajo që është me rëndësi në vitin 1960 kjo tokë me nr. të ngastrës .. a' ka qenë në qarkullim juridik që nënkupton a' ka mundur të ndodh shitblerja, pastaj në emër të kujt a qenë kjo pronë ndërsa paditësi thotë se ka ndërtuar shtëpi me objekte përcjellëse, por i njëjti nuk tregon në cilin vite është ndërtuar shtëpia a' është ber me leje ndërtimi nëse e njëjta është ndërtuar me leje , do të ishte krijuar baza juridike për të kërkuar të drejtën e pronësisë sipas ligjeve në fuqi. Në qoftë se ndërtimi është ber pa leje realisht sipas rregullave të urbanizimit a' mund të quhet shtëpi për shkak se ndërtimi është ber pa leje ndërtimi në pronë të huaj. Bazuar në këto fakte paditësi që kërkon të drejtën e pronësisë nga baza e shitblerjes i referohet nenit 28 të Ligjit LTHMPJ që i bie të drejtën e pronësisë e kërkon me mbajtje. Kërkojmë të refuzohet kërkesë padia.

Kolegji i Specializuar i Dhomës në seancë dëgjimore publike, ka marr Aktvendim procedural me të cilën ka refuzuar propozimet e paditësit që të nxirret historiatit të pronës dhe dëgjimi i palës paditëse.

Kolegji secilës ia ka bërë të mundur që parashtrësën e fjalës përfundimtare ta dorëzoj në afat prej 10 ditëve.

Me dt. 08.05.2024 avokatja A G ka kërkuar ti dorëzohet procesverbali përkundër faktit se procesverbali i është dorëzuar të njëjtës, dhe afat shtesë për hartimin e fjalës përfundimtarë.

Gjykata vlerëson se parashtrësja e fjalës përfundimtare nuk është obligim procedural, por është vetëm një mundësi që pala ka pasur për të dhënë shpjegime të saja sa i përket pretendimeve faktike dhe të juridike në kërkesëpadi .

Me dt. 22.04.2024 AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën e fjalën përfundimtare më dt. 23.04.2024, me të cilën është deklaruar se mbetën në tërësi pran kundërshtimeve, paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë që të argumenton se ka bazë ligjore për aprovimin e drejtës së pronësisë në pjesën e palujatshmerisë në përbërje të ngastrës me nr. ..., me sipërfaqe 0.87.63ha, dhe pjesën e ngastrës me nr. ..., me sipërfaqe prej 2050m2, në vendin e quajtur „...”, ZK Tomoc, Komuna e Istogut, e mbështetur në mbajtje me mirëbesim.

Nga provat që gjenden në shkresa të lendes, nuk është vërtetuar legjitimiteti aktiv i paditësit, legjitimiteti pasiv i të paditurës, se i padituri ka pësuar dëm, si pasojë e veprimeve të paditurës. Në padi ka theksuar se paditësit shitësi para më shumë se 60 vite ja ka shitur pronën blerësit dhe prej asaj kohe është në posedim, atëherë pse ka paditur NSH-në, derisa në padi ai pretendon se ka blerë ngastrën nr. ..., ndërsa kërkon ngastrën nr. ..., dhe bazuar në këtë pretendim të paditurës i mungon legjitimiteti real pasivë në këtë kontest. Ka kërkuar te refuzohet kërkesëpadia.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesëpadia e paditësve, nuk është e bazuar.

Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme, pas përfundimit të procedurës me shkrim bazuar në nenin, 40, lidhur me nenin 42 të Ligjit nr. 06/L-086, ka caktuar seancë dëgjimore publike për dt. 18.04.2024, në mënyrë që secilës palë përveç deklarimeve me shkrim, të deklarohet edhe gojë në argumentimin e pretendimeve të tyre, faktike dhe juridike që kanë të bëjnë me kërkesëpadinë .

DHPGJS, bëri vlerësimin e provave që palët ndërgjyqës i kanë dorëzuar me parashtresa me shkrim, sikundër edhe pretendimet e tyre në seance dëgjimore publike dhe parashtresa të fjalës përfundimtare të paditurës, dhe bazuar me të njëjtat, ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Gjykata bazuar në kërkesëpadinë e paditësit, nga padia bazë, si objekt i kontestit, ka konstatuar se është ngastra kadastrale nr. ..., ZK T, që është në kuadër të ngastrës nr. ..., me sipërfaqe 0.87.67ha, dhe pjesa e ngastrës nr. ..., me sipërfaqe 0.19.95ha, që pretendon se ai e kishte blerë nga shitësi D M diku në vitin 1960, dhe nga ky vite është në posedim faktik, pastaj ka theksuar se ka ndërtuar objekt - ndertës banimi dhe objekt tjetër, duke bashkangjitur një skic të hartuar nga eksperti B G, më dt. 04.08.2015, dhe aeroincizim fotografik, sipas të cilit shifet se ka ndërtim në pjesën e ngastrën nr. ...-2, por kjo ngastër nuk është objekt i kërkesës pronësore, ndërsa nuk ka ndërtim në pjesën e ngastrës nr. ... Mirëpo paditësi duke bashkangjitur padinë C. nr. 215/15, kundër të paditurit D M ish nga fshati G, të ushtruar në Gjykatën Themelore në Pejë, Dega në Istog, që është hartuar nga i njëjti avokat Gani Q Kelmendi, është deklaruar se paditësi ka hyrë në marrëdhënie kontrktore me të paditurin D M në vitin 1989, për ngastër ..., e njëjta që evidentohen në fletë të posedimit nr. 5130/2015, por me këtë padi për ngastrën nr. ..., ka kërkuar sipërfaqen 3672m².

Me ekspertizë të gjeodezisë, të hartuar nga eksperti Gj M dt. 14.06.2022, është bërë identifikimi i ngastrës nr. ..., (përkundër faktit se objekt i kërkesës ka qenë ngastra nr. ...) dhe ngastrës nr. ..., të cilat evidentohen si pronë shoqërorë, në vendin e quajtur „Bregu” ZK T, në emër të PSH Administrata e Kooperativës Bujqësore Xh . Sipas ekspertit ngastra nr. ..., ka sipërfaqe 25286, m², ndodhet në ZK T, me kulturë arë, klasa 5, ndërsa ngastra nr. ..., ka sipërfaqe 6582m², ZK T, me kulturë arë, klasa 5.

Në ekspertizë me shkrim është konstatuar se paditësi ishte në posedim të ngastrës nr. ..., me sipërfaqe 8763m², dhe është posedues i pjesë së ngastrës nr. ..., me sipërfaqe 2050m². Në raport me shkrim eksperti nuk ka hartuar matjet gjeodezike në të gjitha drejtimet, por këto matje janë hartuar në skicë të matjeve, për ngastrën nr. ... Në këtë ngastër nuk ka identifikuar asnjë objekt të ndërtuar . Eksperti nuk ka dhënë sqarime të lidhmeris së ngastres nr. ..., me ngastrën nr. ... Më dt. 27.07.2022, eksperti ka bërë plotësimin e raportit me shkrim, me raport me shkrim duke përshkruar pjesën e ngastrës nr. ..., dhe atë : në pjesën jugore që kufizohet me rrugë, nga pika 15 deri në pikën 1, me gjatësi 60.19, prej pikës deri në pikën 3, me gjatësi 62.12m, e që me këtë pjesë kufizohet me ngastrën nr. ..., prej pikës 3 deri në pikën 4, me gjatësi 48.97metra, , në anën veriore kufizohet me pjesën tjetër të ngastrës nr. ..., në pika detale prej pikës 4 deri në pikën 10, me gjatësi 72.19m, në veriperëndim kufizohet prej pikës 10 deri në pikën 11, nuk janë përshkruar matjet gjeodezike, prej pikës 11deri në pikën 13, me gjatësi 68.4m, Në anën jug perëndimore prej pikës 13 deri në pikën 14, me gjatësi 30.68metra, dhe nga pika 14 deri në pikën 15, me gjatësi 61.19m.

Në lidhje me ngastrën nr. ..., ka bërë përshkrimin e matjeve si në vijim : prej pikës 16 deri në pikën 17, me gjatësi 44.92metra, prej pikjes 18 deri në pikën 20, me gjatësi 46.00metra, prej pikës 20 deri në pikën 16, me gjatësi 44.78metra .

Eksperti i gjeodezisë, me rastin e hartimit të ekspertizës ka thënë se ngastra nr. ..., është në emër të paditësit G M Gj.

Eksperti me rastin e hartimit të ekspertizës, nuk është deklaruar fare se nga cila bazë juridike ngastrat nr. 201-1, dhe ..., janë regjistruar në emër të paditurës, si prona shoqërore dhe në cilin

vit, sikundër edhe AKP-ja, nuk është deklaruar fare për këtë rrethanë se nga cila bazë juridike ngastrat janë të regjistruara si pronë shoqërore në emër të NSH –së .

DHPGJS, me urdhër dt. 08.04.2022, paditësit i ka kërkuar të sigurojë historianit e pronës kontestuese dhe raportin e gjeodezisë .

DHPGJS, në seancë dëgjimore publike dt. 18.04.2024, nuk e pranoi propozimin për nxjerrjes të historiatit të pronës, për faktin se paditësi ka pasur kohë të mjaftueshme për sigurimin e historiatit të pronës që sipas Ligjit për qasje në dokumente publike ka pasur mundësi të siguroi historatin e pronës te organi kompetent i Komunës në Istog , dhe se për këtë kërkesë paditësi ka pasur mundësi ta ushtroi menjëherë pas hartimit të ekspertizës gjeodezike dhe jo të pres në seancë dëgjimore, ndërsa refuzimi i dëgjimit të paditësit në cilësinë e palës, është bërë sepse paditësi ka pasur kohë të mjaftueshme me ardh në gjykim dhe mu deklaruar për kërkesën e tij, sikur të ishte i interesuar pasi njoftimi për seancë dëgjimore, kjo për faktin se njoftimi për seancë ju është dorëzuar avokatit të tij, më dt. 29.02.2024 .

Gjykata vlerëson se pavarësisht nga fakti se eksperti i gjeodezisë ka identifikuar ngastrat nr. .. dhe .., në të cilat është konstatuar se paditësi i ka në posedim këto prona me të gjitha matjet gjeodezike, paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë të vlefshme se nga cila bazë juridike, ka hyrë në posedim të ngastrave lëndore , pastaj në cilin vite, sepse në padi para DHPGJ pretendon se është në posedim prej viti 1960, ndërsa në padi të ushtuar në Gjykatën Themelore në Pejë , Dega në Istog, pretendon se këtë pronë e ka blerë prej viti 1989, pa e vërtetuar faktin se kush e bleu pronën, paditësi apo babai i tij, cili ka qenë çmimi i shitblerjes, çka në të vërtet paditësi ka blerë dhe kush e ka vendosur në posedim paditësin. Përveç kësaj sikur paditësit të ishte në posedim nga vitit 1960, ka pasur interes të siguroi provën nga incizimet e bëra gjatë viti 1980-1983, nga Enti Gjeodezik i Kosovës, të dhëna për ngastrat në të cilat pretendon të drejtën e pronësisë për të vërtetuar faktin e posedimit, kur është bërë incizimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, edhe e paditura AKP-ja, nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi, provë me të cilën do të provonte se kush faktikisht e administron këtë aset të NSH-së, dhe se çfarë është statusi i NSH –së, nëse ajo është në procedurë të likuidimit dhe në procedurë të likuidimit, kjo pronë a' është regjistruar si aset i NSH-së , pavarësisht nga fakti se në certifikata të pronës , kjo pronë është pronë shoqërore në emër të NSH –së.

Me nenin 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086 është paraparë, „ Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt , ajo palë është e obliguar të paraqesë prova , fizike dhe ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi ”

Me nenin 72 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike –pronësore është rregulluar „, Posedimi është i ligjshëm po që se mbështetet në bazën e plotfuqishmërisë juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit . Posedimi është me mirëbesim po që se mbajtësi nuk e di ose nuk mund të dijë se sendin që e mban nuk është i tije ” .

Në rastin konkret, paditësi ka dështuar që me prova të vërtetoi pretendimin e tij faktik mbi posedimin me mirëbesim sikundër edhe pretendimin se posedimin e ka për më shumë se 20 vite, derisa sipas të autorizuarit të paditësit , paditësi jeton në shtetin e Suedisë, pa u deklaruar se nga cili vit.

Gjykata vlerëson se paditësit përveç që nuk ka provuar faktin se është posedues me mirëbesim, ai nuk ka provuar as periudhën e kalimit të kohës prej 20 viteve, sipas nenit 28, paragrafi 4, të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike –pronësore.

Gjykata ka vlerësuar kundërshtimet e të paditurit si të qëndrueshme në parashtresa, seancë dhe në fjalën përfundimtare, me të cilën ka kundërshtuar legjitimitetin aktiv si paditës, si dhe legjitimitetin pasivë të paditurës, sikundër edhe në faktet e thirrura nga paditësi .

Meqenëse paditësi nuk ka vërtetuar pretendimet e tija faktike dhe juridike në fitimin e drejtës së pronësisë për pjesët e ngastrave të kërkuar, kërkesëpadia e paditësit është refuzuar.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos që secila palë ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar Kryesues

Ganimete Puka , Gjyqtare anëtare

Hajrie Shala, Gjyqtare anëtare